



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201400487/3

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandojmë shpejtimin e gjyimit të çështjes civile me numer 00694 akti, datë 07.03.2012 me ankues shtetasin B. H. nga D.*

**Drejtuar :** **Z. Rudin BAQLI**  
Kancelar i Gjykatës së Lartë

**TIRANË**

***I nderuar zoti Baqli,***

Në ankesën e tij datë 26.03.2014 drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi B. H. nga qyteti i Delvinës ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkellen e procedurave gjyqësore, në gjykimin e një çështje civile me Nr.00694 akti, datë 07.03.2012 nga Gjykata e Lartë Tiranë me objekt, kthim sendi dhe detyrimin e të paditurit që të lirojë dhe dorëzojë një Ap.me sip. 34 m2 që ndodhet në qytetin e Tiranës.

Nga studimi me kujdes i ankesës dhe i dokumentacionit përkatës të paraqitur nga ana e ankuesit në institucionin tonë, rezultoi se me vendimin Nr.2653 datë 07.12.2011 të Gjykatës Apelit Tiranë, është vendosur :

Prishja e vendimit Nr.1234 datë 19.03.2004 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Dosja civile aktualisht ndodhet e regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë Tiranë me Nr.00694 akti, datë 07.03.2012 dhe nuk është caktuar akoma për gjykim. Ankuesi pretendon se në disa raste ai i ka kërkuar Kryetarit Gjykatës Lartë për të shpejtuar gjykimin i kësaj çështje por kërkesat e tij nuk janë vlerësuar dhe nuk janë marrë fare në konsiderate.

Ankuesi pretendon gjithashtu se kjo çështje gjyqësore, ka filluar në rrugë gjyqësore në muajin prill 1994 dhe kanë kaluar rreth 10 vjet dhe ajo akoma nuk ka përfunduar. Po kështu del se edhe dy herë të tjera kjo çështje gjyqësore është gjykuar më parë nga Gjykata e Lartë me vendimet Nr.404 datë 06.04.2004 dhe vendimin Nr.200 datë 26.04.2004 të saj dhe tani ajo ndodhet për herë të tretë për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Siç del nga dispozitivi i vendimit Nr.2653 datë 07.12.2011 të Gjykatës Apelit Tiranë, gjykata në përfundim të gjyimit ka vendosur : Prishjen e vendimit Nr.1234 datë 19.03.2004 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

Në shpejtimin e këtij gjykimi civil nga ana e juaj në rastin konkret kemi mendimin se ky rast duhet të trajtohet si ***një rast i veçantë*** për një gjykim të drejtë dhe publikë brenda një afati të arsyeshëm parashikuar nga kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Po kështu në shpejtimin e këtij gjykimi kërkojmë që nga ana e juaj të respektohen kërkesat e nenit 4 të Kodit Procedurës Civile, ku thuhet se: "Gjykata kujdeset për zhvillimin e procesit gjyqësor", dhe të nenit 14 të këtij kodi, ku parashikohet se: "Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë e të gjithjashëm në përputhje me ligjin".

Në lidhje me vonesat e padrejta dhe zvarritje e gjata të gjykimeve nga gjykata si nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu edhe Gjykata Kushtetuese në vendin tonë është theksuar se "***Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar***". E drejta për tu gjykuar para një gjykate kompetente të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por ajo duhet të shihet se po bëhet.

Në këto rrethana dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandim dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të Drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, nga administrata publike", dhe kërkesat e nent 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku parashikohet se: "Avokati I Popullit pranon ankesa, kërkesa dhe njoftime për shkeljen e të të Drejtave të Njeriut, për shkeljen e procedurave gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit".

Për këto arsye, Ju

#### **REKOMANDOJMË :**

1. Marrjen e masave organizative dhe proceduriale për shpejtimin e gjyqësorit të çështjes civile me Nr.00694 akti, datë 07.03.2012 me paditës ankuesin B. H.

2. Mbi qëndrimin dhe masat e marra nga ana e juaj në bazë të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të vihem në dijeni brenda afati 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI**

**Arben SHKËMBI**